

TË RINJTË NË TREGUN E PUNËS

Një guidë e detajuar mbi kushtet
aktuale të tregut të punësimit.





Tabela e përmbajtjes

01 Hyrje	07
02 Tregu i Punës Sot	09
2.1. Tregu i Punës për të Sapo-Diplomuarit	10
2.2. Format e Rekrutimit	14
2.3. Niveli i Pagës	16
2.4. A është Eksperienca e Punës Gjithçka?	18
2.5 Cilat Janë Profesionet me Të Kërkuara?	19
03 Opinionet dhe Pritshmëritë e Studentëve	15
3.1. Punësimi i Preferuar	21
3.2. Sa është Madhësia e Organizatës ku Dëshironi të Punësoheni	22
3.3. Niveli i Dëshiruar i Pagës	23
3.4. Çfarë ka më shumë rëndësi në një Pozicion Pune	26
3.5. Format më të Zakonshme të Kërkimit Për Punë	27
3.6. Cilat Janë Qëllimet e Studentëve në të ardhmen e afërt	28
04 Metodologjia	30

Lista e Figurave

Figura 1 - Sektorët e Ekonomisë që kanë Rekrutuar më shumë Punonjës të Rinj gjatë Vitit Aktual	10
Figura 2 - Shpërndarja e të Punësuarve të Rinj të Sapo-Diplomuar sipas Sektorëve të Ekonomisë	11
Figura 3 - Peshat e të Sapo-Diplomuarve në Raport me Numrin Total të të Punësuarve të Rinj sipas Sektorëve të Ekonomisë	12
Figura 4 - Ofrimi i Trajnimeve për të Punësuarit e Rinj sipas Sektorëve të Ekonomisë	13
Figura 5 - Niveli i Pagës së të Sapo-Diplomuarve në Tiranë	16
Figura 6 - Kriteret Kryesore që Përdorin Bizneset në Rekrutimin e të Sapo-Diplomuarve	18
Figura 7 - Vakancat e Paplotësuara për një Kohë Relativisht të Gjatë sip as Sektorëve të Ekonomisë	19
Figura 8 - Profesionet më të Kërkuara nga Tregu	20
Figura 9 - Sektorët më të Preferuar për Punësim nga Studentët	22
Figura 10 - Preferenca e Studentëve mbi Madhësinë e Organizatës ku Dëshirojnë të Punësohen	23
Figura 11 - Niveli i Dëshiruar i Pagës nga Studentët	24
Figura 12 - Synimet e Studentëve për të Ardhmen e Afërt pas Përfundimit të Studimeve	28

Lista e Tabelave

Tabela 1 - Format më të Përdorura të Rekrutimit	14
Tabela 2 - Format më të Përdorura të Rekrutimit sipas Sektorëve të Ekonomisë	15
Tabela 3 - Niveli i Pagës të Sapo-Diplomuarve sipas Sektorëve të Ekonomisë	17
Tabela 4 - Niveli i Dëshiruar i Pagës sipas Profilit të Studimit	25
Tabela 5 - Faktorët Kryesorë të Studentëve në Përzgjedhjen e një Pozicioni Pune	20
Tabela 6 - Format më të Zakonshme të Kërkimit për Punë nga Studentë	27
Tabela 7 - Format më të Zakonshme të Kërkimit për Punë nga Studentët sipas Profilit të Studimeve	27






1.Hyrje

Ku të kërkoj për punë? Si të aplikoj? Cilët sektorë paguajnë më shumë? A do më duhet përvojë e mëparshme për t'u punësuar? Po miku? A ka rëndësi dega në të cilën kam studiuar? – Këto janë vetëm disa nga pyetjet në mendjen e një studenti apo të sapo-diplomuari që po nis të kërkojë për punë.

Kjo guidë përmban të gjithë informacionin që iu nevojitet të dini kur kërkonit dhe aplikoni për punë, gjatë dhe pas përfundimit të studimeve. Ajo është konceptuar si një ndërthurje mes dëshirave e pritshmërive të studentëve dhe kërkesave e nevojave të bizneseve të ndryshme që e ushtrojnë aktivitetin e tyre në Tiranë. Si e tillë, ajo shërben si një udhërrëfyes për të rinjtë drejt një të kuptuari më të mirë të tregut të punës në Tiranë, por njëkohësisht ndihmon edhe bizneset të njohin më mire gjeneratat e reja të të punësuarve.



Tregu i **Punës Sot**

2.1. Tregu i Punës për të Sapo-Diplomuarit

Tirana është motorri ekonomik i Shqipërisë. Në Tiranë ushtrojnë aktivitetin e tyre rreth 42% e të gjithë bizneseve të regjistruara në vend dhe gjenerohet mbi 40% e PBB të vendit. Vitet e fundit, në Tiranë zhvillojnë aktivitet shumë biznese që ofrojnë shërbime e produkte inovative, njësoj si në ekonomitë më të zhvilluara të Europës. Duket e vështirë të sigurosh një vend pune në Tiranë, apo jo?

Epo, gjërat nuk janë tamam kështu!

71%

e të gjitha bizneseve që operojnë në territorin e Tiranës, kanë punësuar staf të ri përgjatë vitit të fundit të operimit.

76.5%

e të punësuarve të rinj kanë qenë të sapo-diplomuar.

Por cilët janë sektorët që kanë punësuar më shumë staf të ri gjatë vitit të fundit?




Figura 1 - Sektorët e Ekonomisë që kanë Rekrutuar më shumë Punonjës të Rinj gjatë Vitit Aktual

Bizneset që operojnë në fushën e Marketingut, TIK dhe Inovacionit dhe Akomodim e Ushqim renditen të para, ku respektivisht 87%, 85% dhe 81% e tyre kanë punësuar staf të ri gjatë vitit të fundit. Ndërkohë sektorët që punësuar më pak staf të ri gjatë vitit të fundit janë OJF-të dhe Real Estate, ku respektivisht 59% dhe 50% e subjekteve që operojnë në këta sektorë kanë punësuar staf të ri gjatë vitit të fundit. Megjithatë, shifrat tregojnë që tregu i punës në Tiranë është jashtëzakonisht shumë dinamik!

Por cilët janë sektorët kryesorë të ekonomisë ku punësohen të sapo-diplomuarit? Ose, thenë me fjalë të tjera, si shpërndahen të sapo-diplomuarit e punësuar gjatë vitit të fundit, sipas degëve të ekonomisë.




Figura 2 - Shpërndarja e të Punësuarve të Rinj të Sapo-Diplomuar sipas Sektorëve të Ekonomisë

Bizneset që operojnë në sektorin e Tregtisë renditen në krye, ku janë punësuar 23.6% e të sapo-diplomuarve që janë punësuar gjatë vitit të fundit. Në vend të dytë renditen Bankat dhe Institucionet Financiare ku janë punësuar 15.7% e të sapo-diplomuarve. Menjëherë pas tyre renditen Marketingu dhe IT e Inovacion, ku janë punësuar respektivisht 12.4% dhe 10.4% e të sapo-diplomuarve. Sektorët ku janë punësuar më pak të sapo-diplomuar janë Farmaceutika dhe Real Estate me 0.5% secili.

Po sektorët më të hapur për punësimin e të sapo-diplomuarve, cilat janë? Ose, me fjalë të tjera, cilët janë sektorët që punësojnë më shumë të sapo-diplomuar si punonjës të rinj?

Përgjigjen për këtë pyetje mund ta gjejmë në grafikun e mëposhtëm, i cili tregon përqindjen që zënë të sapo-diplomuarit në numrin total të stafit të punësuar në secilin sektor gjatë vitit të fundit.

Në krye renditen bizneset që operojnë në fushën e konsulencës ligjore e financiare ku 94.7% e të punësuarve gjatë vitit të fundit kanë qenë të sapo-diplomuar. Menjëherë pas tyre gjejmë agjencitë e marketingut ku 94.1% të punësuarve të rinj kanë qenë të sapo-diplomuar.

Ndërkohë, niveli më i ulët i punësimit të sapo-diplomuarve haset në bizneset që operojnë në fushën e akomodimit dhe ushqimit, ku vetëm 56.5% e të punësuarve të rinj kanë qenë të sapo-diplomuar.




Figura 3 - Pesha e të Sapo-Diplomuarve në Raport me Numrin Total të të Punësuarve të Rinj sipas Sektorëve të Ekonomisë

52%

e të gjithë bizneseve që operojnë në Tiranë ofrojnë programe trajnimi për stafin e ri të punësuar.

Sektorët që praktikojnë më shumë programe trajnimi për të sapo punësuarit udhëhiqen sërish nga IT dhe Inovacion dhe Marketingu, me respektivisht 84.8% dhe 82.1%. Ndërkohë sektorët që praktikojnë më pak programe trajnimi janë Real Estate dhe Aktivitete Arkitekture e Inxhinierike ku, respektivisht, vetëm 25% dhe 38.1% e tyre ofrojnë programe trajnimi për të punësuarit e rinj.





Figura 4 - Ofrimi i Trajnimeve për të Punësuarit e Rinj sipas Sektorëve të Ekonomisë



2.2. Format e Rekrutimit

Por cilat janë format më të përdorura të rekrutimit nga bizneset që operojnë në Tiranë?

Pavarësisht zhvillimeve mjaft pozitive të viteve të fundit, referenca nga një i njohur mbetet mënyra kryesore se si biznesi rekruton punonjësit e rinj: 92.2% e bizneseve të anketuara deklarojnë se kur kanë nevojë për punonjës të rinj u drejtohen të njohurve të tyre për t'iu referuar dikë.

Një nivel të lartë përdorimi (81%) ka edhe postimi i vakancave në website të dedikuara të cilat ofrojnë shërbime ndërmjetësimi në punësim, si duapune.com, gazetacelesi.al, etj.

No.	Forma e Rekrutimit	Përdorueshmëria
1	Shpallja në website dhe rrjetet sociale të kompanisë	55.8%
2	Postimi në website të dedikuara	81%
3	Nëpërmjet referencave	92.2%
4	Nëpërmjet panairove të punës	37%
5	Nëpërmjet agjencive të rekrutimit	29%
6	Tjetër	17.7%

Tabela 1 - Format më të Përdorura të Rekrutimit

Më shumë se gjysma e bizneseve të anketura (55.8%) deklarojnë se i shpallin vendet vakante të punës në website e tyre apo në rrjetet sociale dhe vetëm 37% e bizneseve të anketuara përdorin panairt e punës për të rekrutuar punonjës të rinj.

Agjencitë e rekrutimit kanë një përdorim relativisht të ulët, në nivelin 29%, dhe me gjasë përdoren për të rekrutuar punonjës mjaft të kualifikuar e në pozicione drejtuese.

Një informacion më i detajuar mbi përdorueshmërinë e formave të rekrutimit nga biznesi në Tiranë mund të gjendet në tabelën më poshtë.

Referenca nga të njohurit është forma kryesore e rekrutimit për të gjithë sektorët e ekonomisë së Tiranës, me përjashtimin e vetëm të OJF-ve dhe Bankave & Institucioneve Financiare, të cilat kanë si formë parësore njoftimin në website të dedikuara për ndërmjetësimin në punësim. Panairt e punës përdoren më së shumti nga bizneset që operojnë në fushën e Energjitikës, ndërsa Agjencitë e Rekrutimit nga bizneset në fushën e Marketingut, TIK e Inovacionit.

Industria	Shpallja në website zyrtar	Postimi në website të dedikuara	Nëpërmjet referencave	Nëpërmjet panairëve të punë	Rekrutues	Tjetër
Marketing	85%	97%	97%	54%	51%	8%
Agjenci Punësimi	83%	83%	100%	50%	50%	33%
Akomodim dhe ushqim	31%	63%	95%	24%	22%	51%
Aktivitate Arkitekture e Inxhinierike	57%	81%	86%	43%	38%	10%
Bankat & inst. financiare	84%	96%	90%	39%	37%	10%
Farmaceutika	50%	100%	100%	50%	25%	0%
Industri ushqimore	64%	88%	96%	48%	20%	32%
Energjitike	67%	87%	93%	73%	47%	0%
TIK & Inovacion	82%	97%	97%	58%	52%	9%
Ndërtim	50%	89%	98%	38%	29%	21%
OJF	63%	85%	80%	26%	15%	11%
Real Estate	17%	75%	75%	8%	8%	8%
Konsulencë ligjore & financiare	43%	93%	93%	33%	30%	3%
Tregti	48%	68%	91%	32%	23%	16%

Tabela 2 - Format më të Përdorura të Rekrutimit sipas Sektorëve të Ekonomisë

2.3. Niveli i Pagës

Cili është niveli i pages që u ofrohet të sapo-diplomuarve? A është i vërtet opinion i përhapur se paga e punës së parë është gjithmonë paga minimale? Në fakt, jo! Vetëm 12% e të sapo-diplomuarve të punësuar për here të parë marrin një pagë të barabartë me pagën minimale.




Figura 5 - Niveli i Pagës së të Sapo-Diplomuarve në Tiranë

Pjesa dërrmuese e të sapo-diplomuarve, 61%, punësohen me një pagë në fashën 40,000 deri në 60,000 Lekë, në nivele të përafërta me pagën mesatare në shkallë vendi.

Akoma më mbresëlënës është fakti që 26% e të sapo-diplomuarve punësohen me një page në fashën 60,000 deri në 90,000 Lekë, e cila është më e lartë se paga mesatare në shkallë vendi. Por cilët janë sektorët që ofrojnë pagat më të larta për të sapo-diplomuarit?

Niveli i pages 90,000 – 120,000 Lekë ofrohet vetëm nga Agjencitë e Marketingut dhe operatorë në fushën e Akomodimit e Ushqimit.

Industria	0 - 40,000 ALL	40,001 - 60,000 ALL	60,001 - 90,000 ALL	90,001 - 120,000 ALL	120,000 ALL
Marketing	20%	49%	22%	10%	0%
Agjenci Punësimi	33%	33%	33%	0%	0%
Akomodim dhe ushqim	26%	39%	33%	2%	0%
Aktivite Arkitekture e Inxhinierike	27%	68%	5%	0%	0%
Bankat & inst. financiare	23%	54%	23%	0%	0%
Farmaceutika	25%	50%	25%	0%	0%
Industri ushqimore	20%	68%	12%	0%	0%
Energjitike	40%	53%	7%	0%	0%
TIK & Inovacion	15%	51%	33%	0%	0%
Ndërtim	1%	67%	32%	0%	0%
OJF	0%	73%	27%	0%	0%
Real Estate	15%	85%	0%	0%	0%
Konsulentë ligjore & financiare	0%	62%	38%	0%	0%
Tregti	4%	68%	27%	0%	0%

Tabela 3 - Niveli i Pagës të Sapo-Diplomuave sipas Sektorëve të Ekonomisë

Pjesa më e madhe e kompanive në çdo sektor aplikojnë paga në nivelin 40,000 – 60,000 ALL për të sapodiplomuarit apo të punësuar pa eksperiencë të mëparshme pune. Por ajo që rezulton interesante është se në industri të caktuara ka kompani që ofrojnë paga më të larta se mesatarja.

2.4. A është eksperiencia e punës gjithçka?

Në këtë seksion do përqëndrohemi tek miti i famshëm i “eksperiencës së punës”, sipas të cilit nëse nuk ke experience nuk gjen dot punë. Në fakt, eksperiencia është një kriter i rëndësishëm për çdo kompani që është në kërkim të një punonjësi të ri dhe, nga ana tjetër, është një kriter që mungon në CV-në e të një sapodiplomuari.

Por a bazohet një kompani vetëm te ky kriter kur punëson apo ka edhe kritere të tjera që e prevalojnë eksperiencën? Më poshtë po iu paraqesim 10 kriteret kryesore që kompanitë në process rekrutimi vlerësojnë tek një punonjës i ri.




Figura 6 - Kriteret Kryesore që Përdorin Bizneset në Rekrutimin e të Sapo-Diplomuarve

Ndonëse mbetet kriteri kryesor i vlerësimit në proceset e rekrutimit, ndryshe nga opinioni gjërisht i përhapur, vetëm **32% e kompanive** të anketuara e cilësojnë eksperiencën e mëparshme si kriterin më të rëndësishëm. Korrektësia, arsimimi dhe aftësitë komunikuese janë gjithashtu kritere mjaft të rëndësishme.

2.5. Cilat janë profesionet më të kërkuara?

Shqipëria u shndërrua shumë shpejt nga një vend ku problemi kryesor ishte papunësia në një vend ku problemi kryesor është mungesa e fuqisë punëtore.

30.5%

e bizneseve të anketuara deklarojnë se kanë vakanca të paplotësuara për një kohë relativisht të gjatë, ose, me fjalë të tjera, kanë kohë që kërkojnë të punësojnë punonjës specifikë dhe kanë një kohë të gjatë që nuk po gjejnë dot profilet e kërkuara.




Figura 7 – Vakancat e Papolotësuara për një Kohë Relativisht të Gjatë sipas Sektorëve të Ekonomisë

Me përjashtim të farmaceutikës, të gjitha degët e tjera të ekonomisë së Tiranës kanë vakanca afat-gjata të paplotësuara. Numri më i lartë i vakancave afatgjata haset në industrinë e Ndërtimit, atë Ushqimore dhe në sektorin e Akomodimit me respektivisht 45.2%, 44% dhe 40.7%. Por cilat janë profesionet më të kërkuara.

Profesione “low-skill” konsiderohen të gjitha ato profesione për të cilat nuk kërkohen aftësi të larta apo përfundimi i studimeve universitare, të tilla si: shofer, shitëse, sanitare, teknikë montimi, pastičier, hidraulik, murator, rrobaqepëse etj.

Të grupuara së bashku, këto profesione përbëjnë rreth 76% të profesioneve më të kërkuara për te cilat tregu ka më shumë nevojë. Meqënëse kjo guidë do të shërbejë edhe për maturantët mund t'i përdorni këto informacione për të rimenduar karrierën tuaj.

Pjesa tjetër e profesioneve më shumë të kërkuara lidhen me fushën e IT dhe Inovacionit edhe për shkak të zhvillimit të menjëhershëm që kjo industri ka marrë, financën, inxhinierinë dhe menaxhimin.




Figura 8 - Profesionet më të Kërkuara nga Tregu





Opinionet & Pritshmëritë **e Studentëve**

3.1. Punësimi i Preferuar

Por cilat janë dëshirat, opinionet dhe pritshmëritë e studentëve sa i përket punësimit të tyre të ardhshëm. Dhe e nisim me pyetjen më të rëndësishme, ku dëshirojnë të punojnë studentët pas përfundimit të studimeve?

Industria më e preferuar nga studentët rezulton Shëndetësia me 24%, por kjo vjen kryesisht prej faktit se të gjithë studentët e degëve të mjeksisë duke përfshirë stomatologjinë, infermierinë, etj. punësohen vetëm në sektorin shëndetësor, ndërsa studentët e drejtimeve të tjera punësohen thuajse në të gjitha degët e ekonomisë.




Figura 9 - Sektorët më të Preferuar për Punësim nga Studentët

Sektori i dytë më i preferuar i punësimit është Arsimi, ku 18% e të anketuarve kanë deklaruar se pas përfundimit të studimeve dëshirojnë të punësohen si mësues të arsimit bazë e të mesëm apo edhe si pedagogë në universitete. Teknologjia dhe Inovacion renditet në vendin e tretë mes preferencave për punësim të studentëve, në nivelin 16%.

Është gjithashtu e rëndësishme të vërehet se punësimi në Administratën Publike, që për vite me rradhë ka qenë ndër të preferuarat e studentëve, aktualisht nuk është mes opsioneve më të preferuara të studentëve pasi vetëm 5% e të anketuarve kanë deklaruar se dëshirojnë t'i bashkohen administratës publike. Akoma më interesant është edhe fakti që vetëm 2% e të anketuarve dëshirojnë të punësohen në industrinë e turizmit, ndonëse kjo e fundit është industria që aktualisht ka rritjen më të madhe në shkallë vendi.

3.2. Sa është madhësia e organizatës ku dëshironi të punësoheni?

Pyetjes mbi madhësinë e organizatës ku dëshirojnë të punësohen, pjesa dërrmuese e studentëve i janë përgjigjur duke theksuar dëshirën e tyre për t'u punësuar në organizata të mëdha me mbi 10 punonjës, ndonëse pjesa më e madhe e biznesve të regjistruara në Shqipëri kanë një numër të ulët punonjësish. Studentët e shkencave ekzakte (89%) janë ata që kanë një preferencë të theksuar për organizatat e mëdha.




Figura 10 - Preferenca e Studentëve mbi Madhësinë e Organizatës ku Dëshirojnë të Punësohen

Sa i përket preferencës për t'u punësuar në organizata relativisht të vogla me 5 - 9 punonjës, ajo është më e theksuar në studentëve e degëve të Teknologjisë dhe Inovacionit (27%), studentëve të degëve të inxhinierisë (26%) dhe studentëve të Ekonomisë e Shëndtësisë me 24% secila degë.

3.3. Niveli i dëshiruar i pagës

Qartazi, punëkërkuessit e rinj kërkojnë punësimin me një nivel më të lartë page krahasuar me ofertën e tregut. Kështu, 53% e studentëve të anketuar dëshirojnë të punësohen me një pagë në nivelin 60,000 – 90,000 Lekë, ndonëse vetëm 26% e bizneseve të anketuara e ofrojnë këtë nivel page për të sapo-diplomuarit. Gjithashtu, 20% e studentëve të anketuar dëshirojnë të punësohen me një pagë në nivelin 90,000 – 120,000, ndonëse ky nivel page ofrohet vetëm nga 1% e bizneseve të anketuara.

Në fashat e pagave 40,000 – 60,000 Lekë, e cila është fasha e ofruar për të sapo-diplomuarit nga 61% e bizneseve të anketuara, dëshirojnë të punësohen vetëm 19.8% e studentëve të anketuar.




Figura 11 - Niveli i Dëshiruar i Pagës nga Studentët

Preferencat për pagën fillestare sipas degëve të studimit jepen në tabelën e mëposhtme.

Fushat e Studimit	0 – 40,000 ALL	40,001 – 60,000 ALL	60,001 – 90,000 ALL	90,001 – 120,000 ALL	120,000 ALL
Humanities	1%	27%	69%	3%	0%
Inxhinieri	1%	2%	51%	37%	9%
Mjedis dhe Bujqësi	0%	13%	72%	15%	0%
Shkenca Ekonomike	2%	20%	53%	18%	8%
Shkenca Ekzakte	0%	29%	71%	0%	0%
Shkenca Mjekësore	0%	14%	44%	30%	12%
Shkenca Sociale	1%	45%	39%	10%	6%
TIK	2%	13%	52%	30%	3%

Table 4 - Niveli i Dëshiruar i Pagës sipas Profilit të Studimit

Studentët e profilizuar në degët Inxhinieri, Ekonomi apo Shkenca Mjekësore janë ata që pretendojnë për paga në nivele më të larta se 120,000 Lekë në punën e tyre të parë. Gjithash-tu, niveli i pages 90,000 -120,000 Lekë pretendohet më së shumti nga studentët e degëve të Inxhinierisë (37%), Mjekësisë (30%) dhe Teknologjisë e Inovacionit (30%). Niveli i pagës 60,000 – 90,000 Lekë është i preferuar kryesisht për studentët e degëve të lidhura me Mjedisin e Bujqësinë (72%), Shkencave Ekzakte (71%) dhe degëve Humanities (69%).



3.4. Çfarë ka më shumë rëndësi në një pozicion pune

Të pyetur mbi faktorët që kanë një ndikim në nivelin e kënaqësisë nga një pozicion i caktuar pune, studentët e anketuar kanë renditur rëndësinë që ka pozicioni i tyre i punës për organizatën, me një dakordësi prej 97.6%. Niveli i pagës renditet i dyti me një dakordësi prej 91.1%.

Faktori	Dakordësia
Niveli i pagës	91.1%
Rëndësia që ka pozicioni specifik i punës për organizatën	97.6%
Impakti që ka pozicioni specifik i punës në shoqëri	77.8%

Tabela 5 - Faktorët Kryesorë të Studentëve në Përzgjedhjen e një Pozicioni Pune

Ndërkohë, vlen të theksohet se studentët janë më pak të motivuar nga impakti që ka për shoqërinë puna që ata do të bëjnë, duke u shprehur në një nivel dakordësie prej 77.8%.

Pra edhe mes studentëve shqiptare vihen re tendencat e shfaqura tashmë mes të rinjve në vendet e BE ku rëndësia e pozicionit të punës në organizatë shihet më me përparësi krahasuar me nivelin e pagës e ku impakti që ka puna e tyre për shoqërinë vlerësohet gjithnjë e më pak.



3.5. Format më të zakonshme të kërkimit për punë

Pavarësisht se edhe studentët, në 85.3% të rasteve, përdorin referencat nga të njohurit për të gjetur punë, kjo nuk është forma kryesore e përdorur nga ata. 88% e studentëve të anketuar kërkojnë për punë duke naviguar në website të dedikuara online.

No.	Forma e Kërkimit për Punë	Përdorueshmëria
1	Nëpërmjet referencave	85.3%
2	Nëpërmjet panairove të punës	40.8%
3	Nëpërmjet website të dedikuara online	88%
4	Linked Inn	59.6%
5	Tjetër	5.5%

Tabela 6 - Format më të Zakonshme të Kërkimit për Punë nga Studentët

Një numër i konsiderueshëm studentësh, 40.8%, deklarojnë se vizitojnë panairët e ndryshme të punës në kërkim të punësimit. Ndërkohë vlen të theksohet se një përdorim të gjërë nga të rinjtë ka edhe rrjeti social Linked Inn, i cili përdoret nga 59.6% e studentëve për të kërkuar punë.

Industria	Website të dedikuara	Linked Inn	Panairët e punës	Nëpërmjet referencave	Tjetër
Humanities	94.3%	60.5%	18.3%	94.3%	11.2%
Inxhinieri	74.7%	58.6%	49.4%	74.7%	5.7%
Mjedis dhe Bujqësi	95.6%	34.7%	56.5%	100%	0%
Shkenca Ekonomike	93.1%	65.8%	35.8%	87.1%	4.2%
Shkenca Ekzakte	92.8%	46.2%	60.7%	100%	3.5%
Shkenca Mjekësore	84.1%	54.2%	43.9%	74.7%	4.6%
Shkenca Sociale	93.9%	78.3%	34.9%	92.7%	10.8%
TIK	81.6%	58.3%	46.6%	78.3%	0%

Tabela 7 - Format më të Zakonshme të Kërkimit për Punë nga Studentët sipas Profilin të Studimeve

Të dhëna të detajuara mbi format e kërkimit për punë sipas degëve të studimit gjenden në tabelën më poshtë.

3.6. Cilat janë qëllimet e studentëve në të ardhmen e afërt?

Punësimi në profesion mendohet se është objektivi kryesor që ka çdo i ri që mbaron universitetin. Por nuk është gjithnjë kështu! 70% e studentëve të anketuar deklarojnë se objektivi i tyre pas mbarimit të studimeve është punësimi.

9% e studentëve të anketuar dëshirojnë të thellojnë edhe më tej njohitë e tyre brenda vendit, me master shtesë apo me kualifikime specifike për profesionet e tyre.

8% e tyre kanë për qëllim thellimin e mëtejshëm të njohurive jashtë vendit dhe punësimin po jashtë vendit.

Ndërkohë që është rendësishme të theksohet një tendencë në rritje e dëshirës për të krijuar sipërmarrje private. 15% e studentëve të anketuar, një numër relativisht i lartë, kanë si objektiv krijimin e një biznesi të tyre pas përfundimit të studimeve.




Figura 12 - Synimet e Studentëve për të Ardhmen e Afërt pas Përfundimit të Studimeve

FUTURE



4. Metodologjia

Anketa e vlerësimit të tregut të punës në Tiranë përfshin një kampionim prej 600 subjektësh që operojnë në industri të ndryshme dhe 600 studentësh nga universitete publikë dhe privat. Mbledhja e të dhënave bazohet në dy pyetësorë të hartuar për secilën kategori të të anketuarëve. Pyetësori për studentët përmbledh pyetje në lidhje me moshën, gjininë, nivelin e studimeve që ndjekin.

Mosha	%
18 vjeç	3.8
19 vjeç	9.8
20 vjeç	25.0
21 vjeç	17.7
22 vjeç	16.7
23 vjeç	10.0
24 vjeç	7.5
25 vjeç	3.8
26 vjeç	2.0
27 vjeç	0.7
28 vjeç	1.5
29 vjeç	0.5
30 vjeç	0.5
33 vjeç	0.2
35 vjeç	0.2
43 vjeç	0.2
Total	100%

Gjinia	Frekuenca	%
Femër	324	54.0
Mashkull	276	46.0
Total	600	100.0

Niveli i Studimit	Frekuenca	%
Bachelor	445	74.2
Master	155	25.8
Total	600	100.0

Pyetëtori i drejtuar punëdhënësve përfshin pyetje në lidhje me llojin e industrisë ku operojnë dhe madhësinë e organizatës.

Industria	Mbulimi në Punësim
Ndërtim	14%
Akomodim dhe ushqim	9.8%
Bankat dhe Inst. Financiare	8.2%
OJF	7.7%
Agjenci marketingu	6.5%
Kompani IT dhe Inovacion	5.5%
Studio ligjore dhe financiare	5%
Industri ushqimore	4.2%
Arkitektura	3.5%
Kompani energjitike	2.5%
Real estate	2.0%
Agjenci punesimi	1%
Farmaceutika	0.7%

